



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më 20/02/2020

**Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit për procedurën me objekt “Shpim pusi për tregun e gjësë së gjallë, Njësia Administrative Mbrostar, Bashkia Fier ” me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë**

AGJENCISE SE PROKURIMIT PUBLIK  
TIRANE

BASHKIA FIER

[20.02.2020]

**Për: [“A.K.M” SHPK, Adresa: Durrës, Rrashbull, Fshati Arapaj ]**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Kerkese per propozim me mjete elektronike**

Numri i referencës së procedurës / lotit : **REF-48036-01-23-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Shpim pusi për tregun e gjësë së gjallë, Njësia Administrative Mbrostar, Bashkia Fier” me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë. Sasitë janë të përcaktuara në shtojcën 12 të DST-ve. Afati kohor për ekzekutim : 49 dite.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “A.K.M” SHPK, numri i NUIS-it L22301501A.**

Vlera totale sipas formularit të ofertes është 5 003 000 leke (*pese milion e tre mije* ) **pa TVSH** dhe **6 003 600 leke** (*gjashte milion e tre mije e gjashteqind*) **me TVSH.**

**2. Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k numri i NUIS-it L78223801E.**

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte 4 803 750 **leke** ( *kater milion e teteqind e tre mije e shtateqind e pesedhete* ) **pa TVSH** dhe 5 764 500 **leke** ( *pese milion e shtateqind e gjashtedhete e kater mije e peseqind*) **me TVSH**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k numri i **NUIS-it L78223801E**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. -OE K.M.K shpk nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne Shtojcen 11 te DST. Konkretisht, jane paraqitur 3 (*tre*) kontrata, “Rik.rruges Principata Arberit” me Bashkine Durres, “Reabilitim i kanalit KUL F.I” (*ne cilesine e nenkontraktorit*), “Rik.rruga Bisht Kamza” me Bashkine Durres. Referuar zërave te situacioneve te ketyre kontratave, asnje element apo zëra punimesh te tyre, nuk janë punë apo zëra punimesh të ngjashme me zërat e punimeve sipas preventivit te objektit te prokurimit (“*Shpim pusi*”). Përveç sa me lart cituar, tek kontrata “Reabilitim i kanalit KUL F.I”, OE K.M.K shpk rezulton ne cilesine e nenkontraktorit te kontraktorit “Caushi” shpk, ku Investitor per kete kontrate rezulton te jete Bashkia Durres, pra eshte nje investim apo kontrate publike qe i nenshtrohet rregullave te prokurimit publik. Ne kete kuptim, OE K.M.K shpk ka detyrimin ligjor, qe se bashku me dokumentat e nenkontraktimit, duhet te paraqiste ne oferte edhe dokumentacionin ligjor te percaktuar nga neni 75 i VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik*” i ndryshuar, (*pra kontraten e kontraktorit me Bashkine Durres*), pasi në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës bazë. Ne baze te nenit 75 te VKM nr.914 date 29.12.2014, kontrata midis kontraktorit dhe nenkontraktorit duhet te jete e noterizuar, gje qe nuk rezulton e tille ne rastin konkret. Formulari i Vleresimit sipas Shtojces 8 per kete rast duhej te leshohej nga Investitori (*Bashkia Durres*), sic percakton neni 75 i VKM nr.914 date 29.12.2014 dhe Formulari tip ne DST, dhe jo nga kontraktori. Akti i kolaudimit eshte bere nga vet kontraktori (*ka vulosur vet pala*) dhe jo nga kolaudator i pavarur, i licencuar.
2. OE K.M.K shpk nuk përmbush kriterin e percaktuar ne piken 2.3.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne Shtojcen 11 te DST, ne te cilen percaktohet “*Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues Inxhinier ne specialitetin perpunim i vendburimeve te naftes dhe gazit ne cilesine e drejtuesit teknik*”. Operatori ekonomik ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion shoqerues ku te tregohet ekperienca e Inxhinierit te kerkuar sipas specialitetit te percaktuar ne piken 2.3/3, per shpim pusesh apo pastrim pusesh.
3. OE K.M.K shpk nuk përmbush kriterin e percaktuar ne piken 2.1.1 “*licence profesionale nga QKB (QKL) per kategorie III.7.B per shpime per uje*”, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne Shtojcen 11 te DST.

Per kete pike, OE K.M.K shpk ka paraqitur ne oferten e tij, kontraten noteriale nr.361 rep., nr.86 kol. date 03.02.2020 me personin fizik F.K., nepermjet se ciles operatori ofertues

K.M.K shpk, na rast shpallje fituesi ne kete procedure, kerkon te kontraktoje specialist per kryerjen e shpime uji te leshuar nga QKL, Kodi III.7.B., sipas Licenses qe disponon personi fizik F.K.

Sipas kesaj kontrate, personi fizik F.K. angazhohet te ofroje per llogari te operatori ofertues K.M.K shpk, punimet per shpim uji (pusi) gjate zbatimit te objektit te pritshem: “Shpim pusi për tregun e gjësë së gjallë, Njësia Administrative Mbrostar, Bashkia Fier”, sipas porosise se bere me kerkese te Porositesit (OE K.M.K shpk). Personi fizik F.K. merr persiper te kryej punimet shpim pusi ne zbatim te objektit te prokurimit, punime qe do te realizohen me mjetin e tij sonde te vene ne dispozicion per kryerjen e ketyre punimeve.

Ne piken 2.1.1 te kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, eshte kerkuar qe “***Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me licence profesionale nga QKB (QKL) per kategorine III.7.B per shpime per uje***” dhe jo subjekt tjetër i nenkontraktuar prej tij, i cili nuk eshte operator ofertues. Autoriteti kontraktor ka percaktuar qarte ne dokumentin e DST, “*Njoftimi i Kontrates*”, ne piken 2.14.1, ***se nuk pranohet nenkontraktimi***. Per me teper, operatori ofertues K.M.K shpk ne shtojcen 1/1 “Deklarate per paraqitje Oferte te pavarur”, ka perzgjedhur alternativën e percaktuar ne piken 6/a. Pra, kete licence profesionale nga QKL, duhet ta kishte vet operatori ofertues K.M.K shpk.

Ne kete oferte te paraqitur nga operatori ofertues K.M.K shpk, nuk rezulton qe oferta te jete paraqitur si bashkim operatoresh nepermjet nje marrveshje noteriale midis ketyre subjekteve, sic percaktohet ne nenin 75 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik*” i ndryshuar, dhe personi fizik F.K. nuk figuron si anetar i nje bashkimi operatoresh, ne menyre qe te kete te drejten te marri persiper kryerjen e ketyre punimeve, apo te vere ne dispozicion kapacitetet e tij ligjore (*licence profesionale nga QKB (QKL) per kategorine III.7.B*) dhe teknike (*mjetet*). Per me teper, ne oferte nuk eshte paraqitur asnje dokument i personit fizik F.K., ne perputhje me nenin 75 te VKM nr.914 date 29.12.2014.

Operatori ofertues K.M.K shpk, nuk mund te paraqesi si kapacitet te permbushur ligjor, kapacitetin e nje subjekti tjetër (*licencen profesionale nga QKL*), me te cilin nuk ka krijuar marrdhenie ligjore apo ofertuar, sipas menyres se percaktuar ne rregullat e prokurimit.

4.Dokumentacioni i paraqitur per mjetin sondë nuk eshte i plotë, pasi nuk evidentohen te dhenat e kerkuara ne piken 2.3.5 te kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, sa i perket kerkeses qe sonda duhet te kete ne paisje te makinerise nje kompresor jo me pak se 25 atm. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion per te dhenat teknike te kompresorit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ **A.K.M** ” shpk numri i **NUIS-it L22301501A**, Adresa: **Durres, Rrashbull, Fshati Arapaj** , se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme **5 003 000 leke** (pese milion e tre mije ) **pa TVSH** dhe **6 003 600 leke** (gjashte milion e tre mije e gjashteqind) **me TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesise se Prokurimit te Bashkise Fier, Lagjja “**Kastriot**”, **Rruga “Ramiz Aranitasi”** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **12.02.2020**

Ankesa: ka ose jo,- **Jo**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Armando SUBASHI**